



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 018
Prishtinë, më 16 maj 2008, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
16 MAJ 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Slllobodan Petroviq**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 82 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, ka propozuar emërimin e anëtarëve të organit përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Për arsye të urgjencës që ka emërimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, propozoj që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës.

Kuvendi miratoi propozimin e cekur më lart.

Deputeti Berat Luzha tha se ka parashtruar një kërkesë me shkrim që Kuvendi të nxjerrë një deklaratë politike dhe ta përgatit një aktpadi kundër ish-kryeprokurores së Tribunalit të Hagës.

Ai kërkoi që kjo kërkesë, që i plotëson të gjitha kriteret procedurale, të radhitet në rend dite të kësaj seance.

Kryetari tha se kërkesa e deputetit Berat Luzhat, e mbështetur edhe nga pesë deputetë të tjerë, do të shqyrtohet në seancën e ardhshme.

Kuvendi i vazhdoi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 18 e 21 dhe më 29 prill 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën jokontestimore,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbaruese,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me procedimin e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave,
10. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK- së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
12. Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit
13. Emërimi i organit përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura me 18 e 21 dhe më 29 prill 2008

Procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura me 18 e 21 dhe më 29 prill 2008, u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet e Qeverisë për rregullimin e përdorimit adekuat të tokave.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Esat Brajshori** i parashtroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me veprimet e kësaj ministrie që qyteti antik, Ulpiana, të merret në mbrojtjen e UNESCO-s, si trashëgimi kulturore e dorës së parë.

Ministri **Valdet Beqiri** iu përgjigj pyetjes së deputetit Brajshori.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi dy pyetje Kryeministrit të Kosovës. Njëra kishte të bënte lidhur me veprimet e Qeverisë për ndalimin e prerjeve ilegale të pyjeve, kurse tjetra me kaptazhimin dhe uzurpimin arbitrar të burimeve ujore.

Përgjigjet mbetën për seancë e radhës, ngase Kryeministri, Hashim Thaçi, nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me implementimin e Strategjisë - shkollat promovuese të shëndetit 2008-2017.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me implementimin e Strategjisë 2008-2012 për parandalimin dhe eliminimin e etheve hemorragjike.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të organizatave shëndetësore buxhetore të vitit 2007 në vitin 2008.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputeti **Berat Luzha** i parashtroi pyetje ministres së Punëve të Brendshme lidhur me gjendjen e sigurisë në fshatin Debëllde dhe rreth tij.

Përgjigjja mbeti për seancë tjetër.

Deputeti **Driton Tali** iu parashtroi pyetje përfaqësuesve të Qeverisë lidhur me shitjen e rrymës nga ana e KEK-ut kompanisë së Feronikelit –Alferonit me çmim më të lirë sesa e importon vetë.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Suzanë Novobërdali** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me punën e mjekëve në institucionet shëndetësore publike dhe ato private.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Novobërdali.

Deputeti **Ibrahim Makolli** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me mënyrën e ofrimit të dëshmive të pensionistëve kontributdhënës për rritjen e pensioneve nga 40 në 75 €.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Makolli.

Deputetja **Suzanë Novobërdali** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me kriteret e punësimit të stafit të ri nëpër kompanitë publike.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Novobërdali.

Deputetja **Qamile Morina** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me realizimin e Projektit për rinovimin dhe zgjerimin e objektit të mjekimit intensiv në QKUK.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

Deputeti **Hajdin Abazi** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me licencimin e mësimdhënësve dhe përmirësimin e të ardhurave të tyre.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Abazi.

10 pyetjet që nuk morën përgjigje në seancën e sotme, mbeten për të marrë përgjigje në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Idriz Vehapi**, tha se qëllimi i këtij projektligji është të rregullojë çështjet të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për mbrojtjen e pyjeve të Kosovës. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për pyjet bëhet për arsye se nuk ka gjetur zbatueshmëri të plotë dhe për shkak të mangësive që kanë ekzistuar për një zhvillim të qëndrueshëm të pylltarisë.

Fushëveprimtaria e këtij projektligji janë objektivat, masat dhe programi i politikave të pylltarisë dhe të zhvillimit rural, shërbimet në pylltari, si dhe baza e të dhënave dhe informacioneve për politikat e ruajtjes, të mbrojtjes dhe të zhvillimit të pylltarisë.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për pyjet është në pajtim me të plotë me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe të drejtësisë në programin e politikave të zhvillimit, të ruajtjes dhe të mbrojtjes së pylltarisë e të zhvillimit rural, të shërbimeve në pylltari, të kërkimit dhe të sigurimit profesional, si dhe të bazës së të dhënave dhe të informacioneve për politikat në pylltari.

Ky projektligj përmban 5 nene, të cilat kanë të bëjnë me rekomandimet që i bën Agjencia Pyjore e Kosovës për çështjet e përgjithshme që ndërlidhen me pyjet dhe pylltarinë dhe shqiptimin e masave ndëshkimore.

Zbatimi i këtij Projektligji nuk do të ketë implikime buxhetore. Projektligji ka edhe deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Eset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha**, dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Kosara Nikoliq**, si dhe deputetët: **Bahri Hyseni**, **Riza Smaka** dhe **Elhame Hetemi**, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 10,
Kundër-----41,
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin për kualifikimet kombëtare.

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, **Enver Hoxhaj**, tha se Projektligji synon që ta rregullojë sistemin kualifikimeve kombëtare, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe që do të rregullohet nga autoriteti kombëtar i kualifikimeve.

Edukimi dhe arsimi sot nuk është çështje që iu referohet vetëm atyre që janë në banka shkollore, por është një fenomen kompleks, i cili i referohet dhe me të cilin ka të bëjë çdokush. Prandaj, ky projektligj synon që t'i ofrojë qasje në arsim dhe në aftësim çdokujt, në çdo moshë dhe në çdo kohë. Ky projektligj e ndërlidh sistemin tonë të arsimit dhe sistemin tonë të aftësimeve ose konkretisht arsimin formal dhe joformal përmes Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Me këtë projektligj mundësohet që të njihet dhe të pranohet çdo diplomë, çdo dëftesë, çdo formë e kualifikimit, çdo nivel i dijes brendapërbrenda Kosovës. Përveç kësaj, projektligji mundëson që edhe këto diploma, ky sistem i kualifikimeve të jetë i pranueshëm dhe në të njëjtën kohë i njohur edhe në Bashkimin Evropian.

Projektligji është në harmoni të plotë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Në fund, ministri **Hoxhaj** kërkoi nga deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë projektligj, ngase Kosova do të jetë nga shtetet e para të rajonit që legjislacionin e saj, të kësaj fushe, e harmonizon me atë të UE-së.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Drita Kadriu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Agim Veliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Eset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Dritë Maliqi**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanoviq**, si dhe deputetët: **Shumbin Demaliaj**, **Naim Rrustemi**, **Gjylnaze Syla**, **Sanije Aliaj**, dhe **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----50;
Kundër----- 7;
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Projektligjin për kualifikimet kombëtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional dhe raportues, si dhe komisionet kryesore që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në vazhdim, mbledhjen e kryesoi anëtari i Kryesisë, Sllobodan Petroviq.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën jokontestimore

Kryesuesi informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për procedurën jokontestimore, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11,12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Pastaj, Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 60;

Kundër----- 0.

Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për procedurën jokontestimore.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbarese

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për procedurën përmbarese, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Gani Koci, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, propozoi që për shkak të gabimeve teknike në Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi shqyrtimi i tij të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryesuesi, pas diskutimit të deputetëve lidhur me propozimin e Komisionit për Buxhet e Financa, e hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 48;

Kundër----- 3;

Abstenime-----8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Shqyrtimi i dytë Projektligjit për procedurën përmbarese të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 64;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 .

Pastaj, Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 69;
Kundër----- 0.
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi Ligjin për përdorimin civil të eksplozivëve.

9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me procedimin e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave

Kryesuesi i informoi deputetët se pas miratimit, në parim, të Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave, Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues,

Kuvendit i ka paraqitur Raportin dhe i ka rekomanduar që Projektligji t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Kryesuesi ftoi kryetari e këtij komisioni, Gani Kocin, që ta arsyetojë rekomandimin.

Gani Koci, duke e arsyetuar rekomandimin tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa, pas shqyrtimit përfundimtar të Projektligjit dhe të amendamenteve të veta, në konsultim dhe sugjerim të ekspertëve ndërkombëtarë nga vendet që kanë eksperiencë të duhur legislative dhe praktikë të luftimit të pastrimit të parave, ka vlerësuar të nevojshme t'i propozojë Kuvendit tërheqjen e këtij Projektligji për parandalimin e pastrimit të parasë nga procedura e rregullt e shqyrtimit të mëtutjeshëm në Kuvend, dhe t'i dërgohet Qeverisë për ripunim.

Kryesuesi e hapi debat për propozimin e Komisionit për Buxhet e Financa.

Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ky grup e përkrah rekomandimin Komisionit për Buxhet e Financa sepse mendojmë që nuk duhet të futemi në inflacion ligjor e pastaj ligji të jetë i pazbatueshëm dhe të mos ketë kurrfarë efekti në stabilizimin e sistemit ekonomik dhe financiar.

Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se e mbështet propozimin e komisionit që ky Ligj t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Shkumbim Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se e mbështet propozimin e komisionit që ky Ligj t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se edhe ky grup është i pajtimit që ky Ligj të tërhiqet.

Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se e mbështet propozimin e komisionit që ky Ligj t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar të “7+” , tha se e mbështet propozimin e komisionit që ky Ligj t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Kosara Nikoliq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, tha se e mbështet propozimin e komisionit që ky Ligj t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Komisionit për Buxhet e Financa. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 53;
Kundër----- 1.
Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Projektligji për parandalimin e pastrimit të parasë t'i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

10. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Qeveria, në pajtim me nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/47, për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, ka propozuar kandidatin për anëtar të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi ftoi zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçin që në emër të Qeverisë ta paraqesë propozimin.

Hajredin Kuçi, tha se Qeveria e ka pranuar me kohë propozimin që Sejdi Rexhepi, profesor-doktor i ekonomisë, të zgjedhet anëtar i Bordit të Autoritetit Qendror Bankar dhe të njëjtin me konsensus e ka miratuar, ndërsa tani po ia propozon Kuvendit për miratim. Biografia e z. Sejdi Rexhepit, së bashku me propozimin iu është shpërndarë, prandaj në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ju lus që ta jepni pëlqimin dhe përkrahjen e këtij propozimi.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deklaroi se e përkrah propozimin e Qeverisë.

Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se e përkrah propozimin e Qeverisë.

Ibrahmi Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se e mbështet propozimin e Qeverisë.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se ky grup nuk e mbështet këtë propozim dhe nuk do ta votojë.

Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se grupi e ka shqyrtuar propozimin e dhënë, ka vërejtje të natyrës politike dhe nuk do ta përkrah, duke marrë parasysh se zoti Sejdiu është jo vetëm anëtar, por edhe funksionar në Partinë Demokratike të Kosovës, respektivisht deputet në Asambleenë komunale.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, deklaroi se e mbështet propozimin e Qeverisë.

Kosara Nikoliq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-ës, tha se e mbështet propozimin e Qeverisë.

Në vazhdim seancën plenare e kryesoi Kryetari **Jakup Krasniqi**.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me propozimin e Qeverisë për anëtarin e Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës i dhanë edhe deputetët : **Driton Tali, Haki Shatri, Riza Smaka, Gani Buqinca, Ibrahim Gashi, Safete Hadërgjonaj, Sabri Hamiti** dhe **Gjylnaze Sylaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Qeverisë. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 43;

Kundër----- 7.

Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

VENDIM

1. Sejdi Rexhepi zgjedhet anëtar i Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
2. Mandati i anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës zgjat pesë (5) vjet.

11. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët lidhur me Propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve të tij në komisionet parlamentare.

Kryetari i hodhi në votim këto propozime. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për--shumicë votash;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

VENDIM

1. Deputeti **Bujar Bukoshi** emërohet anëtar i Komisionin për Integritet Evropian në vend të deputetit Lutfi Haziri,
2. Deputetja **Melihate Termkolli** emërohet anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në vend të deputetit Bujar Bukoshi,
3. Deputeti **Lutfi Haziri** emërohet anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi në vend të deputetes Melihate Termkolli.

12. Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të Përfundimit të Kryesisë, grupet parlamentare i kanë propozuar kandidatët si përfaqësues të Kuvendit për anëtarë të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kryetari i hodhi në votim propozimet. Rezultati i votimit ishte, si vijon :

Për-----53;
Kundër----- 1.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

VENDIM

1. Anëtarë të Këshillit të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, emërohen deputetët:

1. Gani Koci,
2. Haki Shatri dhe
3. Suzanë Novobërdaliu.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit zgjat 2 vjet.

13. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari i njoftoi deputetët se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me nenin 96 pika 4 të Ligjit për prokurimin publik dhe me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit, ka propozuar 3 gjyqtarë për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ky propozim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me emrat e 3 anëtarëve iu është shpërndarë deputetëve.

Me qenë se askush nuk u paraqit për diskutim, Kryetari i hodhi në votim propozimet. Rezultati i votimit ishte, si vijon :

Për-----48;
Kundër----- 1.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

VENDIM

1. Formohet Organi Përzgjedhës i Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
2. Anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur zgjedhen:
 1. Rifat Zylfiu,
 2. Isak Ademi dhe
 3. Besa Krajku.
3. Ngarkohen anëtarët e Organit Përzgjedhës të Pavarur që në afatin sa më të shkurtër të bëjnë përzgjedhjen dhe Kuvendit t'i propozojnë kandidatët për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:30 .

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale